

K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FARMAWORLD Sh.p.k."

ndërmjet:

1)FRANCO FOLLI,i Ferdinando,qytetar italian,lindur ne Bologna me 21.2.1943,banues ne Via "Emilia" 381/A Indice di S.Lazzaro di Savena Bologna (Itali,

2)GUERRIERO Alberico Antonio Marino,i Domenicos,me shtetesi italiane, lindur ne Apricena (Foggia),me 12 gusht 1948,farmacist.banues ne Margherita di Savoia (Foggia),Via Vittorio Veneto 114/A.

3)ANNA MARIA PISANELLO,e Settimita,me shtetesi italiane,lindur ne Lecce me 25 09.1951.banuese ne Rome,"Piazza dei Consoli"nr 11

4)ILIR VUTHI,i Hilmiut,me shtetesi shqiptare,lindur ne Tirane,me 16.1.60 banues ne Tirane,Rruga "Azim Vokshi" P.8,Ap.5

5)PULIAMB QALLINI,i Duranit,me shtetesi shqiptare,lindur ne Fier,me 1.1.1930,banues ne Tirane,Rruga "Azim Vokshi" P.119,Sh.1,Ap.16,inxhinjer,

6)FATOS KADESHA,i Memalit,me shtetesi shqiptare,lindur ne Tirane,me 20.01.1944,banues ne Tirane,Rruga "Ali Visha",P.13,Sh.5,Ap.81,farmacist.

Te dyja palet ne baze te ligjeve te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise nr. 7492, dt.4.03.1992 "Per investimet e huaja"; nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite tregetare" dhe te dispozitave te tjera te legjislacionit shqiptar, u morren veshe si me poshte

Neni 1

Te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me qellim qe te zhvillojne veprimtari te perbashket tekniko-ekonomike te emertuar:

ne shqip : "FARMAWORLD Sh.p.k."

ne italisht : "FARMAWORLD S.r.l."

Shoqeria e ka seline e vet ne Tirane(Republika e Shqiperine),Rruga "Thanas Ziko",P.8,Sh 1,Ap.8.

Neni 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "FARMAWORLD Sh.p.k." eshte person juridik i se drejtes shqiptare.Veprimtaria e saj zhvillohet ne perputhje me kete kontrate, me Statutin e saj dhe ne dispozitat e tjera te legjislacionin shqiptar.

Statuti i Shoqerise bashkelidhet dhe eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj dhe ne asnjë rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakëve dhe as keta te fundit nuk pergjigjen personalisht e nuk perballojne humbjet e Shoqerise tej kuota- ve te derdhura prej tyre per themelimin e kesaj Shoqerie.

Shoqeria nuk pergjigjet gjithashtu per detyrimet e Shtetit shqiptar dhe anasjelltas.



Neni 3
Objekti

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- A) Tregtimin e produkteve farmaceutike, sanitare, veterinarë, kozmetike, parfumerie, diagnostike, substanca kimike për prodhimin e produkteve të lartpërmendura, si edhe helme, stupefacente dhe hemoderivante, pajisje mjekësore e farmaceutike, bime medicinale, fitomedicamente, pajisje mjekësore, struktura e aparate në përgjithësi për funksionimin e mirë të strukturave të mesiperme, me shumice e pakice, me ose pa depozite apo depozitues për import-eksport dhe perfaqësi;
- B) Shpërndarje-furnizim të artikujve të lartpërmendur me shumice e pakice, si me anën e farmaceutikave të krijuara nga vetë Shoqëria ashtu edhe jo me anë farmaceutikash, në Shqipëri dhe jashtë saj;
- C) Themelimin dhe/ose ngritje ndërmarrjesh për prodhimin e drejtperdrejti të grupeve merceologjike, si në pikën A) të mesiperme;
- D) Bashkëpunim të bashkëpunimit me ndërmarrje të tjera homologe edhe të huaja;
- E) Krijim zyrash teknike dhe shërbimi për asistencë e marketing si edhe zyra ose firma opo çdo gjë tjetër që nevojitet për bashkëpunimin e lartpërmendur.

Neni 4

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 25.000 (njëzetepesa mijë) USD baraz me 2.500.000 (dy miliona e pesëqind mijë) lekë.

Ortakët marrin pjesë në kapitalin themeltar me kontributet e tyre në natyrë dhe në para, si më poshtë :

- 1) Franco Foli, me kontribut prej..... 4.500 USD
- 2) Guerriero Alberico, me kontribut prej..... 4.500 USD
- 3) Anna Maria Pisanello, me kontribut prej..... 4.000 USD
- 4) Ilir Vuthi, me kontribut prej..... 4.000 USD
- 5) Pullumb Qallimi, me kontribut prej..... 4.000 USD
- 6) Fatos Kadesha, me kontribut prej..... 4.000 USD

Kontributet e ortakëve janë regjistruar në librin e llogarive dhe në regjistrin e posaçëm të Shoqërisë.

Shtimi i kapitalit themeltar dhe kontributet e ortakëve nuk janë të kufizuara.

Neni 5

Perberja e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbehet nga një vlerë prej 25.000 (njëzetepese mijë) USD, ose 2.500.000 (dy miliona e pesëqind mijë) lekë, të ndara në 250 pjesë të barabarta (kuota), me një vlefte prej 100 USD secila. Në bazë të kontributeve të lartpërmendur dy ortakëve Franco Foli e Guerriero Alberico Antonio Marzin u takojnë nga 45 (dyzetepese) kuota secilit, të numëtuara përkatësisht nga nr.1 në 40 dhe nga Nr.41 në 90 ndërsa ortakëve Anna Maria Pisanello, Ilir Vuthi, Pullumb Qallimi dhe Fatos Kadesha u takojnë 160 kuota nga 40 secilit, të numëtuara përkatësisht nga nr.90 në 130, nga nr.131 në 170, nga nr.171 në 210 dhe nga nr.211 në 250.

Në këtë mënyrë kuotat e pjesëmarrjes në bazë të këtyre raporteve nga 36 % të kapitalit themeltar u perkasin Franco Folit dhe Guerriero Alberico-s dhe 64 % gjithë ortakëve të tjerë nga 16 % secilit.

Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe derdhur krejtësisht dhe u perkasin ortakëve si më sipër.

Shumat në para të kapitalit themeltar të Shoqërisë në themelimin e sipër janë depozituar e mbështetur në Bankën Italo-Shqiptare në Tiranë në llogari rrjedhese nr....

Shumat e depozituara vërtetohen me certifikatën e lëshuar nga Banka.



-3-

Meni 6

Asamblea e ortakëve emeron organet drejtuese të Shoqërisë.

Meni 7

Shoqëria e fillon veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit të saj në Gjykatën e Shkallës së parë dhe në zyrën e tatimeve të rrethit të Tiranës.

Meni 8

Fitimi neto i realizuar nga Shoqëria, si të jenë zbritur shumat që u takojnë detyrimeve ligjore, fondit rezervë dhe kostove të tjera, u ndahen ortakëve proporcionalisht me kuotat e tyre.

Fitimi dhe shperblimet e tjera të ortakut italian mund të transferohen lirisht në valuta të konvertueshme në Itali, pasi të jenë paguar taksat në Shqipëri.

Meni 9

Veprimtaria ekonomike e Shoqërisë dhe investimet e ortakut të huaj mbrohen nga Shteti, i cili i garanton atij dhe Shoqërisë të njëjtin trajtim dhe të njëjtat të drejta që ligji u njeh personave juridike shqiptarë.

Meni 10

Ortakët detyrohen reciprokisht të ruajnë sekretin e dokumentacionit të Shoqërisë që ka të bëjë me informacionin dhe përvojën e akumuluar gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si edhe të dhenat e ndryshme që i përkasin asaj. Ata marrin të gjitha masat e duhura për të shmangur publikimin e tyre, qoftë edhe pjesërisht.

Ortakët janë përgjegjës për demot që mund të rrjedhin nga mosrespektimi i këtyre detyrimeve.

Meni 11

Organet drejtuese të Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

- a) Asamblea e ortakëve
- b) Administratorët dhe/ose Administratori i vetëm
- c) Eksperti Kontabel i Autorizuar

Menyrë e përberjes dhe funksionet e tyre përcaktohen në menyrë të detajuar në Statutin e Shoqërisë bashkëlidhur.

Brenda tri javëve nga regjistrimi i Shoqërisë në organet kompetente do të thirret Asamblea e ortakëve në selinë e Shoqërisë për të përcaktuar personat dhe detyrat e secilit.

Administratorit të vetëm ose administratorëve u jepen kompetencat përkatëse të pranuarë prej këtyre të fundit për kryerjen e funksioneve të ngarkuara. Ata mbajnë përgjegjësi për të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë.

Të drejtat dhe detyrat e Administratorit ose të Administratorëve përcaktohen hollësisht në Statutin e Shoqërisë.

Neni 12
Vlefshmeria e kontrates

Kjo kontrate eshte lidhur per nje periudhe dhjate vjeçare, e riperteriteshme. Kjo periudhe mund te zgjatet ose te shkurtohet me vendim te Asamblese se ortakëve.

Kjo marreveshje si edhe dokumentet perkatese bahkelidhur perfaqesoj-ne vullnetin e plote te Paleve. Ajo mund te modifikohet me nje marreveshje te re me shkrim,duke e njoftuar vendimin perkates nje vit para.

Neni 13
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Mosmarreveshjet eventuale,qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj kontrate midis paleve,ose midis tyre dhe organeve kompetente leshuese ose anuluese te autorizimeve,ose mosmarreveshjet qe mund te lindin dhe qe mund te prekin funksionimin dhe administrimin e Shoqerise do te behet sipas dispozitave te Statutit.

Neni 14

Dispozita te hollesishme per Shoqerine percaktohen ne Statutin e saj qe i bashkelidhet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

Neni 15

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare origjinale,ne gjuhet shqip dhe italisht,duke pasur te dy tekstat vlere te barabarte.

Kontrata u perpilua ne Tirane,me 22.12.1993 dhe permban 15 nene ne kater faqe.

PER ORTAKET SHQIPTARE

PER ORTAKET ITALIANE

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"FARMAWORLD" Sh.P.K"

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "FARMAWORLD", me seli ne Tirane, qe me poshte do te quhet "SHOQERIA", eshte krijuar ne baze te kontrates te lidhur midis ortakeve: Franco Fali, Guerriero Alberico Antonio Marzio, Anna Maria Pisanello me shtetesi italiane, nga njera ane, dhe Ilir Vuthi, Pullumb Qallimi e Fatos Kadesha me shtetesi shqiptare, nga ana tjetere, identiteti i te cileve shenohet ne Aktin e themelimit (kontrata), ne perputhje me ligjet e Asamblese Popullore te Republikes se Shqiperise nr.7512 dt.10.8.1991 "Per Privatizimin..." nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si edhe me dispozitat e tjera ligjore ne fuqi te legjislacionit shqiptar.

Palet, mbi kete baze, u muarren vesh te hartojne kete Statut, si me poshte:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSME

Neni 1
Emertimi

Shoqeria emertohet:

ne shqip: "FARMAWORLD Sh.P.K"
ne italisht: "FARMAWORLD S.r.l."

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, Rruga "Thanas Ziko, P.8, Sh.I, Ap.8.

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik me pergjegjesi te kufizuar dhe veprimtarine e saj e zhvillon ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin themelues (kontrata) dhe ne kete Statut

Neni 3

O b j e k t i

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj: A) tregtimin e produkteve farmaceutike, sanitarë, veterinarë, kozmetikë, të parfumerisë e diagnostikë, substanca kimike per prodhimin e produkteve te siperme, si dhe helme, stupefacente e hemoderivante; pajisje mjeksore e farmaceutike; bime mjeksore, fitomedicamente dhe struktura e aparatura ne pergjithesi, per funksionimin e mire te gjithë strukturave te lartpermendura, me pakice e shumice, me ose pa depozite e depozitues, per import-eksport e perfaqesi. B) Shperndarjen me shumicë e pakicë te ketyre produkteve me farmaci te veta o me krijim farmacish ne Shqiperi e jashte saj; C) krijim dhe ose ngritje ndërmarrjesh prodhimi, apo grupe merceologjike per artikujt e pikës A të mësipërme; D) Bashkëpunime dhe bashkëpunim me Shoqëri të tjera të njejtë vendase ose të huaja; E) Krijim zyrash teknike e të shërbimit për asistencë dhe marketing si edhe zyra ose ndermarrje, apo çfarëdo tjetër që mund të ketë nevojë bashkëpunimi i mësipërmë.

./..

(Handwritten signatures)
Pisanello
Fali
Vuthi
Kadesha



- 2 -

Neni 4 Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e Shoqerise eshte caktuar deri me 31 dhjetor 2004.
Ky afat mund te zgjatet ose te shkurtohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve.

Ky Statut dhe Akti i themelimit (kontrata) ketu e bashkelidhur perfaqesojne marreveshjen e plote te paleve. Kjo marreveshje mund te ndryshohet me nje marreveshje te re me skrim midis paleve.

Statuti mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se jashtezakoneshme te ortakeve.

Shoqeria pervec selise se saj ne Tirane mund te hape ose te mbylle agjensi, filiale dhe zyra si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj.

Njesite e lartpermendura me seli ne Shqiperi do t'i neneshtrohen legjislacionit shqiptar, ndersa ato qe e kane seline jashte shtetit do t'i neneshtrohen legjislacionit te vendit ne te cilin ushtrojne veprimtarine e tyre.

Neni 5 Pergjegjesia

Shoqeria pergjigjet krejtesisht me pasurine e saj dhe ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve dhe as keta te fundit nuk pergjigjen personalisht dhe nuk perballojne humbjet e Shoqerise tej kuotes se tyre te derdhur per krijimin e shoqerise.

Shoqeria nuk pergjigjet gjithashtu per detyrimet e Shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 25.000 (njetzet e pesemija) dollare USA, baraz me leke 2.500.000 (dy milion e peseqind mija) leke.

Ortaket marrin pjese ne kapitalin themeltar me kuotat e tyre, si ne natyre ashtu edhe ne para, si vijon:

- 1) Franco Foli me nje kontribut prej 4.500 USD
- 2) Guarriero Alberico me nje kontribut prej 4.500 USD
- 3) Anna Maria Pisannello me nje kontribut prej 4.000 USD
- 4) Ilir Vuthi me nje kontribut prej 4.000 USD
- 5) Pullumb Qallimi me nje kontribut prej 4.000 USD
- 6) Fatos Kadesha me nje kontribut prej 4.000 USD

Kontributet e ortakeve jane regjistruar ne librin e llogarive dhe ne regjistrin e posaçem te Shoqerise.

Rritja e kontributeve dhe e kapitalit nuk eshte e kufizuar.



- 3 -

Neni 7
Perberja e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar perbehet nga kuotat e 25.000 dollareve USD baraz me 2.500.000 leke te ndare ne 250 pjese te barabarta, secila me nje vlere prej 100 USD te numertuara ne seri nga Nr. 1 deri 250 te paguara krejtesisht.

Kur kapitali themeltar shtohet me pjese, ortaket kane te drejte te marrin pjese ne te me perparesi, proporcionalisht me kuoten e tyre.

Shtimi i kapitalit themeltar miratohet nga Asambleja e Ortakeve.

Shoqeria gjithashtu ka te drejte ta pakesoje kapitalin themeltar ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Te gjitha pjeset qe perbejne kapitalin themeltar jane krejtesisht te paguara e te likuiduara krejtesisht ne perputhje me aktin themelues (kontraten).

K R E U II
Te drejtat dhe detyrat e paleve
Neni 8
Te drejtat e paleve

Palet kane te drejte te :

- Marrin pjese ne administrimin e Shoqerise ne perputhje me aktin themelues (kontraten) dhe me kete Statut,
- Marrin pjese ne ndarjen e fitimeve,
- Marrin pjese ne administrimin e Shoqerise me anen e perfaqesuesve te tyre prane organeve te Shoqerise,
- Marrin dijeni per librat e Shoqerise dhe shqyrtojne permbajtjen e tyre,
- Paraqesin para Asamblese se Ortakeve dhe perpara Administratorit te vetem ose administratoreve propozime,
- Heqin dore nga Shoqeria, duke u propozuar cedimin e kuotave te tyre ortakeve. Kur keta te fundit heqin dore nga e drejta e parablerjes, ortaku doreheqes ka te drejte t'ua cedoje kuoten e vet te treteve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 9
Detyrimet e ortakeve

Detyrimet kryesore te ortakeve jane :

- Te bejne derdhjen e kuotes se tyre ne kapitalin themeltar ne baze te ketij Statuti dhe Aktit themelues (kontrate),
- T'i japin Shoqerise ndihmen e nevojshme me qellim qe te arrihet cdo objektiv qe ka lidhje me objektin e Shoqerise.

Neni 10
Doreheqja nga Shoqeria dhe cedimi i kuotave

Cdo ortak gezon te drejten e doreheqjes nga Shoqeria, duke e motivuar vendimin e tij perpara Asamblese se Ortakeve sipas nenit 8 te ketij statuti.

Doreheqja eventuale nuk e liron ortakun doreheqes nga detyrimet e tij te marra me pare ndaj Shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e kesaj te fundit ndaj ortakut doreheqes.

./..



Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te cedueshme ndermjet ortakeve, sipas ligjit. Keto mund t'u cedohen te treteve, jo ortake, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar dhe ne kushte jo me te favorshme nga ato qe u jane ofruar me pare ortakeve. Projekti i cedimit i njoftohet Shoqerise dhe secilit ortak, duke zbatuar te tera kerkesat e nenit 49 te Ligjit per Shoqerite Tregetare. Cedimi i pjeseve te kapitalit themeltar vertetohet nga noteri.

K R E U III
KUSHTET EKONOMIKE
Neni 11
Veprimtaria e Shoqerise

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne baze te parimeve ekonomike dhe rezultatet pasqyrohen, ne bilancet e saj.

Neni 12
Viti financiar

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar sidoqofte do te mbyllet me 31 dhjetor 1993.

Neni 13
Shperndarja e Shoqerise

Kur Shoqeria shperndahe, pasi zbriten shumat qe i perkasin pasivit, Shoqeria ndan mbetjen e kapitalit themeltar ndermjet ortakeve perpjesimisht me kuotat e tyre te derdhura per themelimin e Shoqerise, kur nuk ka pasur mundesi per cedim.

Neni 14
Pasurite e Shoqerise

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejten e disponimit sipas qellimeve dhe objektiveve te veprimtarise se saj.

Ligji parkujdeset dhe mbron pronen e Shoqerise si edhe te drejtat e ortakeve te huaj.

Neni 15
Fonde rezervë

Shoqeria krijon nje fond rezerve dhe fonde te tjera te posacme, te nevojshme per zhvillimin e veprimtarise se saj.

Perberja, shumata totale dhe burimet per krijimin e fondit rezerve, si edhe perdorimi dhe administrimi i cdo fondi te posacem, percaktohet nga administratoret ose nga administratori i vetem, ne perputhje me legjislacionin shaiptar.

Shoqeria mund t'i disponoje te gjitha mjetet financiare - ato te sajat dhe me kredi - qe nevojiten per realizimin e qellimeve te Shoqerise.

[Handwritten signatures and notes]



- 5 -

Neni 16
Fitimi

Fitimi neto, qe rezulton nga bilanci, pasi te jene zbritur shpenzimet e administrimit, amortizimet dhe detyrimet e tjera financiare, me vendim te Asamblese se Ortakeve ndahet ndermjet ortakeve, proporcionalisht me kuotat e derdhura nga secili per krijimin e kapitalit themeltar, ne perputhje me ligjet Shqiptare.

Fitimi qe i perket ortakut te huaj, pasi te jene paguar taksat perkatese sipas legjislacionit shqiptar, mund te transferohet jashte shtetit ne valute te konvertueshme, ne perpushje me dispozitat e aktit themelues (Kontrata)

Neni 17
Bilanci

Bilanci i Shoqerise do te mbahet me dy valuta: ne leke shqiptare dhe ne lira italiane ose dollarë amerikanë ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Ministri i Financave mund te beje perjashtim nga ky rregull.

Veprimtaria financiare mbaron ne 31 dhjetor te çdo viti.

Bilanci vjetor duhet te paraqitet brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

Neni 18
Veprimtaria financiare

Veprimtarite financiare te Shoqerise realizohen sipas planeve ekonomike financiare dhe programeve ekonomike vjetore.

Programet ekonomike financiare duhet te parashikojne aktivin dhe pasivin te shprehura ne monedhe te konvertueshme.

Keto duhet te permbajne nje parashikim te fitimeve te kosmos dhe ne cdo rast te rezultateve (fitime dhe humbje).

Kontabiliteti dhe llogaria ekonomike do te shkruhen dhe do te mbahen ne Shqiperi duke i dhene ortakut te huaj informatat e nevojshme sipas nevojave te tij.

Rezultatet financiare te veprimtarise se Shoqerise do te percaktohen ne baze te bilancit vjetor. Konvertimi i monedhes shqiptare ne divize te huaj dhe anasjelltas do te behet me kursin e kembimit te bankes se Shqiperise.

KREU IV
ADMINISTRIMI

Neni 19
Asamblea

Organi kryesor vendimor i Shoqerise eshte Asamblea e ortakeve, ne te cilen marin pjese me te drejte vote perpjestimisht me kuoten e kapitalit themeltar te secilit.

Asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme. Ajo kryesohet nga nje anetar i zgjedhur nga ortakët. Kryetari emerohet nje sekretar qofte dhe jo ortak.



Neni 22

Ne proces-verbalet e Asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme, kur nje ortak e kerkon, duhen te pasqyrohen deklaratat e tij.

Vendimet e Asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, jane te detyrueshme per te gjithë ortakët, perfshire ketu edhe ata qe nuk jane te pranishem ose qe kane votuar kundra.

Neni 23

Administratori i vetem ose administratorët dhe kompetencat e tyre

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem ose nga disa administratorë te emeruar per tre vjet te ripërteritshme.

Ne cilesine e administratorit te vetem eshte emeruar zoti. *Ilir Hilmi Vuthi*

Neni 24

Kompetencat e administratorit te vetem dhe/ose te administratorëve

Organi administrativ i Shoqerise eshte administratori i vetem dhe/ose disa administratorë, te cilet emerohen dhe konfirmohen ne detyren e tyre nga Asamblea e ortakëve sipas propozimit te ketyre te fundit.

Administratorit te vetem dhe/ose administratorëve u njihen te gjitha kompetencat per administrimin e Shoqerise.

Administratori i vetem dhe/ose administratorët jane kompetente te ushtrojne çdo akt dhe veprimtari ne emer dhe per llogari te shoqerise ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut ia njej ekskluzivisht Asamblese se ortakëve.

Administratori i vetem dhe/ose administratorët jane personalisht pergjegjes kundrejt Shoqerise dhe te treteve per mos rrespektimin e ligjeve, te Statutit dhe per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise. Kompetencat eskluzeve te administratorit te vetem dhe/ose te administratorëve jane si vijon :

- Te organizojne veprimtarine e Shoqerise me qellim qe te realizohen te gjitha programet e saj,
- Te sigurojne administrimin e Shoqerise,
- Te perfaqesojne Shoqerine ne marrdhenie me te tretet branda caqeve te objektit te Shoqerise, me perjashtim te çeshtjeve qe ligji dhe ky statut i le ne kompetencen e Asamblese se ortakëve,
- Te sigurojne nje zbatim te drejte e te sakte te vendimeve te Asamblese se ortakëve,
- Te perfaqesojne Shoqerine perpara autoritateve gjyqesore, arbitrale dhe administrative ndaj te treteve,
- Te pergatisin raportin mbi administrimin e Shoqerise, si edhe inventaret dhe kontabilitetin vjetor,
- Te paraqesin perpara Asamblese se ortakëve raportin e realizimit te objektivave te Shoqerise,
- Te administrojne e drejtojne pasurine e mjetet financiare te Shoqerise brënda caqeve te caktuara nga Asamblea.

[Handwritten signatures and initials]

Neni 25

Kontrolli mbi administrimin e veprimtarise se shoqerise

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te Shoqerise dhe te filialeve te saj emerohet nje ekspert kontabel i autorizuar, i cili ngarkohet dhe revokohet nga Asamblea e zakonshme e ortakeve qe perfaqesojne nje vlere me te madhe se gjysmen e kapitalit themeltar per nje periudhe prej gjashte vitesh financiare, te perseritshme.

Eksporti kontabel i autorizuar nuk duhet te beje pjese ne asnje menyre ne Shoqeri dhe ne filialet e saj.

Neni 26

Transformimi i Shoqerise

Transformimi i Shoqerise nga Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne Shoqeri te formave te tjera behet me miratimin unanimit te ortakeve, ndersa transformimi ne nje Shoqeri anonime behet me aprovimin e ortakeve qe posedojne me shume se 3/4 e kuotave te kapitalit themeltar.

Neni 27

Marrdheniet e punes

Marrdheniet e punes ne Shoqeri, ne filialet e saj dhe ne seksionet vendosen ne baze te kontrates se punes. Per ato ceshtje qe nuk percaktohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi te punes.

K R E U V

PUSHIMI I VEPRIMTARISE

Neni 28

Mbyllja

Shoqeria mbyllet me mbarimin e afatit te kohezgjatjes te caktuar ne aktin themelues (kontrata), me perjashtim te rasteve kur ky afat shtyhet.

Shoqeria mund ta pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit, me kerkesen dhe vendimin e Asamblese se ortakeve ose ne rastet e parashikuara ne aktin e themelimit.

Neni 29

Shperndarja

Shoqeria shperndahet :

- a) Kur mbaron afati i kohezgjatjes se saj
- b) Ne rast te pamundesise se realizimit te objektit te Shoqerise
- c) Me miratimin e te gjithe ortakeve.

Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a large signature on the left and several smaller ones on the right.



**Neni 30
Likuidimi**

Likuidimi i Shoqerise do te behet sipas rregullave te legjislacionit ne fuqi, ne momentin e likuidimit.

Ne rast likuidimi te Shoqerise :

- Asamblea e jashtezakonshme emerom komisionin e likuidimit i cili i paraqet asaj bilancin e likuidimit ne baze te te cilit Shoqeria pushon se ekzistuari.

- Pasuria dhe mjetet e vena ne dispozicion te Shoqerise nga ortakut i huaj mund te kthehen ne vendin e origjines.

- fitimet e marra si rezultat i veprimtarise se Shoqerise dhe i filialeve si edhe fondet financiare ndahen midis ortakeve perpjestimisht me kapitalin e poseduar nga secili ortak pasi te jene likuiduar te gjitha pasivitetet dhe shpenzimet.

Neni 31

Kur pushon veprimtaria e nje filialeje per shkaqe te saj, afati i mbylljes se saj, percaktohet nga administratori i vetem

Likuidimi i filialeve do te ndjehet te njejten procedure qe parashikohet per pushimin e veprimtarise te Shoqerise.

Neni 32

Mosmarreveshjet dhe ligji i zbatueshem

Mosmarreveshjet eventuale, qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise midis ortakeve ose midis ketyre te fundit dhe organeve kompetente shqiptare leshuese te autorizimit per krijimin e Shoqerise do te zgjidhen se vijon:

1) Per mosmarreveshjet lidhur me:

a) diskriminimin dhe mosmarreveshjet e tjera, qe kane lidhje me kompensimin dhe demshperblimet sipas neneve 9 dhe 10 te ligjit per investimet e huaja.

b) vlefshmerine dhe vazhdimesine e autorizimit te leshuar nga autoritetet shqiptare per themelimin e Shoqerise ne baze te ligjit te larpermendur.

Ne rast se mosmarreveshjet nuk zgjidhen miqesisht, ceshtja do t'i paraqitet per zgjidhje gjykates arbitrale nderkombetare te Dhomes se Tregtise Nderkombetare te Parisit, e cila do te caktojte tre arbitra ne perputhje me rregulloren e Komisionit te Kombeve te Bashkuara per te Drejten Tregtare Nderkombetare.

Arbitrazhi do te behet ne Paris dhe procedura do te zhvillohet ne gjuhen frenge.

Vendimi arbitral do te jete i formes se prere dhe i detyrueshem per palet ne konflikt.

[Handwritten signatures and initials at the bottom of the page]



2) Tutte le altre controversie tra i soci oppure tra quest'ultimi e gli organi statali, saranno giudicate dai tribunali albanesi competenti conformemente alle regole di procedura previste dalla legislazione albanese.

Articolo 33

Il presente Statuto, composto di 33 articoli è stato redatto in lingua albanese ed italiana in cinque esemplari originali in ogni lingua, avendo i due testi uguale fede.

Fatto in Tirana, il 9 novembre 1993

PER I SOCI ALBANESI

PER I SOCI ITALIANI